



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1158/Prot.  
3

Tiranë, më 14 11 2016

**REKOMANDIM**

Nr. 28 datë 14 11 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Canal Grande" p.f. Durrës, në përfundim të të cilit,

**KONSTATOVA:**

Në zbatim të Urdhërit Nr.231, datë 26.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "Canal Grande" p.f. Durrës, konform procedurave administrative, me objekt kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Canal Grande" p.f. Durrës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr. 231, datë 26.10.2016 të Komisionerit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e ka kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por e plotësoi atë në datë 10.11.2016.
2. Kontrolluesi nuk aplikon informimin e subjekteve të të dhënave personale, për mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet kamerave të video-vëzhgimit (CCTV), në ambientet ku ushton aktivitetin e tij.

3. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 18, 21 dhe 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKR-QKB.
- Rregullore e brendëshme mbi funksionimin e hotelit.
- Listëpagesa e kontributeve të pesë punëmarrësve.
- Kontratë individuale pune.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën: “...sipas urdhërit të ministrisë së brendëshme janë vendosur kamerat, prej një periudhe të shkurtër dhe nuk i kam ditur detyrimet e këtyre konstatimeve që ka proces verbali. Këto detyra që u lanë, do i riparojmë së shpejti”.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel “Canal Grande” p.f. Durrës, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 10.11.2016.

Kontrolluesi, Hotel “Canal Grande” p.f. Durrës, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ka dokumentuar masat e marra për riparimin e konstatimeve nga grupi i kontrollit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Hotel “Canal Grande” p.f. Durrës, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.

2. Kontrolluesi Hotel "Canal Grande" p.f. Durrës, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe pajisjen e punëmarrësve me deklarata konfidencialiteti, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga dalja e këtij akti.
3. Kontrolluesi Hotel "Canal Grande" p.f. Durrës, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit mbi përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky akt.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 14.11.2016

**BESNIK DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**